

20/06/2019

Specialistët e Institutit të Monumenteve të Kulturës kanë kryer një inspektim në kishën e Shën Todrit në fshatin Kadipashaj, Lushnje.



Specialistët e Institutit të Monumenteve të Kulturës kanë kryer një inspektim në kishën e Shën Todrit në fshatin Kadipashaj, Lushnje.

Inspektimi kishte si synim kontrollim teknik të monumentit dhe evidentimim e problematikave për hartimin e projektit të restaurimit. Gjatë inspektimit u konstatua se monumenti kishte dëmtime në strukturën e çatisë, si dhe disa probleme të karakterit konstruktiv.

Gjithashtu, u inspektua gjendja e pikturës murale, ikonostasit dhe elementëve të tjerë drusorë. Nga ana e specialistëve do të hartohet projekti i restaurimit të kishës, që përfshin ndërhyrje restauruese dhe konsoliduese për problematikat aktuale të monumentit.





Instituti i Monumenteve të Kulturës